



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary


DATE/A:	07.08.2025
REFERENC-Ë:	25/1812/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Hib Petrol" Sh.p.k. Ferizaj, Depo e karburanteve-rezervuarët e naftës, benzinës dhe gazit të lëngëzuar naftor (GLN) në Bablak, Ferizaj
CC:	Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës së MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën me Nr.Prot.25/1812/MMPHI, për t'u pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "Hib Petrol" Sh.p.k. Ferizaj, për veprimtarinë: Depo e karburanteve- rezervuarët e naftës, benzinës dhe gazit të lëngëzuar naftor (GLN) në Bablak, Ferizaj.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur,

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 25/1812/MMPHI
Datë: 07.08.2025


Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrotjen e Mjedisit, nenin 11, paragrafin 3 të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

Vendim

Aprovohet kërkesa për t'u pajisur me Leje Mjedisore, me Nr.Prot.25/1812/MMPHI, për kompaninë "Hib Petrol" Sh.p.k. Ferizaj, për veprimtarinë: Depo e karburanteve-rezervuarët e naftës, benzinës dhe gazit të lëngëzuar naftor (GLN), me kapacitet të rezervuarëve si në vijim: rezervuarët e naftës me kapacitet: $V_1 = 4 \times 1\,000\,000$ litra, $1 \times 2\,114\,319$ litra, rezervuarët e benzinës me kapacitet: $V_1 = 100\,271$, $V_2 = 100\,409$, $V_3 = 100\,340$, $V_4 = 100\,177$, $V_5 = 100\,219$ dhe $V_6 = 50\,991$ litra dhe rezervuarët e gazit të lëngëzuar naftor (GLN) me kapacitet $3 \times 105\,m^3$ dhe $1 \times 100\,m^3$, në ngastrat kadastrale: P-72209002-00306-0, P-72209002-00304-1, P-72209002-00305-0, zona kadastrale Bablak, Komuna e Ferizajt.

Operatori obligohet:

- Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;



- Të mirëmbahet shtresa mbrojtëse e rezervuarëve mbitokësorë kundër rrjedhjeve, që janë të pajisur me sensorë që lajmërojnë rrjedhjen, për ta parandaluar ndotjen e tokës dhe ujërave nëntokësore;
- Të mirëmbahet sistemi për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave sipërfaqësore, nga të gjitha sipërfaqet funksionale dhe ujërave të zeza;
- Të mirëmbahen kolektorët e sipërfaqes operationale, që janë të lidhur me separatorin në vajrave;
- Të mirëmbahet sipërfaqja operationale, e cila është e betonuar dhe izoluar;
- Të mirëmbahen dhe zbrazen rregullisht kontejnerët, sipas kontratës me kompaninë e mbeturinave;
- Të pastrohet dhe mirëmbahet separatori i vajrave dhe grupa septike, për ta parandaluar ndotjen e tokës dhe ujërave nëntokësore;
- Të monitorohen ujërat, që dalin pas trajtimit në separatorin e vajrave, para shkarkimit në rrjetin e kanalizimit, raporti i analizave të dërgohet në MMPHI;
- Për sistemin menaxhues mjedisore të ketë personin e profilit mjedisore;
- Të mirëmbahen sipërfaqet gjelbëruese me drunj dekorativ dhe bimë barishtore;
- Të implementohet plani aksional për aksidente;
- Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoni MMPHI-në;
- Pas përfundimit të aktivitetit të bëhet rehabilitimi dhe rikultivimi i zonës sipas kriterëve ligjore dhe përshkrimit në aplikacion.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës me Nr.Prot.25/1812/MMPHI, për t'u pajisur me Leje Mjedisore, të operatorit "Hib Petrol" Sh.p.k. Ferizaj, për veprimtarinë: Depo e karburanteve- rezervuarët e naftës, benzinës dhe gazit të lëngëzuar naftor (GLN), me kapacitet të rezervuarëve si në vijim: rezervuarët e naftës me kapacitet: $V_1 = 4 \times 1\,000\,000$ litra, $1 \times 2\,114\,319$ litra, rezervuarët e benzinës me kapacitet: $V_1 = 100\,271$, $V_2 = 100\,409$, $V_3 = 100\,340$, $V_4 = 100\,177$, $V_5 = 100\,219$ dhe $V_6 = 50\,991$ litra dhe rezervuarët e gazit të lëngëzuar naftor (GLN) me kapacitet $3 \times 105\,m^3$ dhe $1 \times 100\,m^3$, në ngastrat kadastrale: P-72209002-00306-0, P-72209002-00304-1, P-72209002-00305-0, zona kadastrale Bablak, Komuna e Ferizajt, si dhe vizitës së realizuar në terren, MMPHI konstaton që operatori i ka plotësuar kushtet administrative dhe mjedisore për t'u pajisur me Leje Mjedisore.

Kërkesës për t'u pajisur me Leje Mjedisore i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:



- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr.13/99, të dt.30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit, NUI 810662834, datë: 30.03.2005, të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- Pëlqim Mjedisor, Nr.: 24/5575/1-ZSP/25, datë: 21.01.2025, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Pëlqim, Nr.0002552/23, datë: 23.05.2023, të lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent;
- Pëlqim, Nr.63/19, datë: 23.01.2019, të lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent;
- Pëlqim, Nr.0003770/24, datë: 24.09.2024, të lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent;
- Pëlqim, Nr.207/19, datë: 01.04.2019, të lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent

Andaj, duke u bazuar në të lartcekuarat si dhe paragrafët 1, 2 dhe 4 të nenit 12, nenin 13 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, **aprovon** kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "Hib Petrol" Sh.p.k. Ferizaj, për veprimtarinë: Depo e karburanteve- rezervuarët e naftës, benzinës dhe gazit të lëngëzuar naftor (GLN), Bablak, Komuna e Ferizajt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi t'iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Ferizaj;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit

- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.